



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:071073
Datë: 24.05.2024
Numri i dokumentit: 05731197

CA.nr.5245/24

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka-Kryetar i Kolegjit, Malsor Kryeziu dhe Liridon Maloku, antarë të kolegjit, në çështjen kontestimore sipas propozimit të paditësit - propozuesit të sigurimit, R. (I.) D. nga P., të cilin me autorizim e përfaqëson avokate B. Sh., me adresë rr. xxxx, F. K., kundër të paditurve - kundërshtarëve të sigurimit, B. G. dhe T.(H.) T. nga P., të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm, avokat N. Sh., me seli në P., duke vendosur sipas propozimit për caktimin e masës së sigurimit, duke vendosur sipas ankesës së ushtruar nga propozuesi i masës së sigurimit, ushtruar përmes të autorizuarës së tij, avokate B. Sh. nga F. K., kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me numër C.nr.1689/23, i dt.18.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt **23.05.2024**, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET SI E PA BAZUAR ankesa e propozuesit R. D. nga P., ushtruar përmes të autorizuarës së tij, avokate B. Sh. nga F. K., ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm me numër C.nr.1689/23, i datës 18.03.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar, me numër C.nr.1689/23, të dt:18.03.2024, duke vepruar sipas propozimit për caktim të masës së sigurimit, ka vendosë si në vijim:

I. REFUZOHET propozimi i paditësit - propozuesit të sigurimit R.(I.) D. me të cilin ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit në pjesën e parcelës kadastrale me nr.00794-16 ZK Prishtinë, Komuna P., me sipërfaqe prej 414m² dhe të i ndalohet të paditurit të dytë – kundërshtarit të

sigurimit T. (H.) T., shitja apo çfarëdo ndryshimi i pronësisë, deri në përfundimin e kësaj procedure gjyqësore me aktgjykim të plotëfuqishëm.

II. DETYROHET paditësi-propozuesi i sigurimit R.D., që në emër të shpenzimeve për përfaqësuesin e përkohshëm të të paditurve - kundërshtarëve të sigurimit, avokat N. Sh., të deponojnë shumën e mjeteve prej 717.60 euro, në arkën e kësaj gjykate dhe dëshminë e deponimit t'ia dorëzojnë gjykatës, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktvendimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit të përcaktuar ligjor, ankesë ka ushtruar propozuesi i masës së sigurimit-paditësi R. D. nga P., përmes të autorizuarës së tij, avokate B. Sh. nga F. K., për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke e kundërshtuar në tërësi aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e propozuesit të masës së sigurimit, dhe aktvendimi i ankimuar të priset dhe çështja të kthehet në ri vendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë, brenda afatit ligjor është ushtruar nga përfaqësuesi i përkohshëm i kundërshtarëve të masës së sigurimit, avokat N.Sh. nga P., duke i kundërshtuar në tërësi pretendimet ankimore të propozuesit, me propozim që ankesa të refuzohet dhe aktvendimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të ankesës, analizimit dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 pika (b) të LPK-së, konstatoi se:

Ankesa e propozuesit R. D. nga P., ushtruar përmes të autorizuarës së tij, avokate B. Sh. nga F. K., rezulton e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës, konstatohet se propozuesi i masës së sigurimit me datën 21.03.2023, ka ushtruar padi për vërtetim të së drejtës së pronësisë, me propozim për caktimin e masës së sigurimit ndaj të paditurëve-kundërshtarëve të masës së sigurimit B. G. dhe T. T. të dy nga P., ku me propozimin për caktimin e masës së sigurimit ka kërkuar nga gjykata që t'iu ndalohej kundërshtarëve të masës së sigurimit shitja, ngarkesa me barrë, tjetërsimi apo çfarëdo ndryshimi në librat kadastral i parcelës kadastrale P-71914059-00794-16, me sipërfaqe prej 414 m², me shfrytëzim aktual "Tokë Ndërtimore" e cila gjendet në Prishtinë.

Meqë, nga tentativat e gjykatës për dërgimin e njoftimit për dhënien e përgjigjes me shkrim ndaj propozimit për caktim të masës së sigurimit, kundërshtarët e masës së sigurimit kanë rezultuar të panjohur me adresën e tyre të banimit, gjykata me propozim të propozuesit kundërshtarëve të masës së sigurimit u ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm avokat N. Sh. nga P., i cili në përgjigjen e dhënë me shkrim e ka kundërshtuar në tërësi propozimin për caktimin e masës së sigurimit me arsyetimin se propozuesi nuk ka ofruar prova përkatëse për mbështetje të propozimit dhe ka propozuar që i njëjti të refuzohet i pa bazuar.

Gjykata e shkallës së parë, pas zhvillimit të procedurës lidhur me caktimin e masës së sigurimit, nxjerrjes dhe administrimit të provave, me aktvendimin e ankimuar ka vendosur për refuzimin e propozimit për caktimin e masës së sigurimit me vendosje më të hollësishme si në dispozitiv të tij.

Gjykata e shkallës së parë, lidhur me mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, në pjesën arsyetuese të aktvendimit të ankimuar, ka theksuar se lidhur me propozimin për vendosjen e masës së sigurimit, gjykata i referohet kushteve të përcaktuara në nenin 297 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e cila parasheh se: *“Masa e sigurimit mund të caktohet: a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës së tij subjektive, dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vetë, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do të ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”*, që do të thotë se këto kushte duhet të plotësohen në mënyrë kumulative për caktimin e masës së sigurimit.

Në drejtim të pikës së parë, nga shkresat e lëndës dhe provat e propozuara nga palët, pala propozuese nuk e ka bërë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive të tij, sepse sipas certifikatës së pronës nr.P-71914059-00794-16 të dt.18.03.2024, me sipërfaqe 414m², ku 390m² përbëhet nga oborri ndërsa 24m² është shtëpia, të lëshuar nga Komuna e P., ZK P., si pronar me 1/1 të pronës evidentohet i padituri i dytë – kundërshtari i sigurimit T.T., ndërsa paditësi – propozuesi i masës së sigurisë, ka pohuar faktin se i njëjti nga parcela kontestuese ka blerë vetëm 200m², andaj meqenëse paditësi-propozuesi në petitum ka kërkuar masën e sigurisë në sipërfaqen prej 414m², ndërsa pohon se nga kjo sipërfaqe i njëjti ka blerë vetëm 200m², atëherë nëse do të caktohej masa e sigurimit për sipërfaqen prej 414m², palëve të treta që kanë të drejtat e tyre në sipërfaqen e mbetur prej 212m², do t’iu cenohej e drejta e shfrytëzimit të pronës, pra paditësi-propozuesi nuk ka arritur ta saktësoj dhe konkretizoj të drejtën e tij subjektive.

Po ashtu nga Kontrata mbi Shitblerjen e Paluajtshmërisë e dt.03.10.1998, e lidhur në zyrën e avokatit R. B., P., ku si dëshmitarë kanë qenë F. G. dhe A. G., e lidhur në mes shitësit B. G. – tani i padituri i parë – kundërshtari i sigurimit dhe blerësit R. D. – tani paditësi – propozuesi i masës së sigurisë, me adresë xxx me çmim prej 29.500 DM, gjykata konstaton se në këtë kontratë nuk është cekur se cila njësi kadastrale apo cila pjesë e njësisë kadastrale është objekt shitblerjeje, pra nuk mund të identifikohet për cilën parcelë bëhet fjalë.

Sa i përket pikës së dytë të par. 1 të nenit 297 të LPK-së, propozimi i masës së sigurisë parashtrohet në rastet kur ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë, pala kundërshtare do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës. Gjykata konstaton se nuk ekziston ky rrezik, sepse vet paditësi-propozuesi, ka pohuar faktin se i njëjti e shfrytëzon një pjesë të parcelës së lartcekur në mënyrë të papenguar dhe të pandërprerë që nga viti 1998, në të cilën edhe e ka rindërtuar shtëpinë e cila ka qenë nga viti 1998 deri në 2004.

Nisur nga këto rrethana, Gjykata duke vlerësuar parashtrimet e palëve në procedurë si dhe mbi bazën e provave që gjenden në shkresat e lëndës, gjen se propozimi i propozuesit të sigurimit është i pabazuar.

Gjykata vlerësoi se propozuesi i sigurimit nuk ka arritur të argumentoj se janë plotësuar këto kushte ligjore për caktimin e masës së sigurimit. Bazuar në të lartcekurat, gjykata e refuzoi propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurimit, pasi vlerësoi se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 297.1 pika a) dhe b) e LPK-së, për t'u caktuar një masë e tillë.

Lidhur me detyrimin për pagimin e shpenzimeve për përfaqësuesin e përkohshëm, gjykata vendosi konform nenit 81.2 të LPK-së, ashtu që e detyroi paditësin që të deponoj shumën e përgjithshme prej 717.60 euro, përkatësisht për përpilimin e parashtrësës shumën prej 312 euro, ndërsa për përfaqësim në një seancë shumën prej 405.60 euro, konform TOAK.

Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje, vlerëson se përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, është i drejtë dhe i ligjshëm, dhe se aktvendimi i atakuar nuk është i shoqëruar me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, i njëjti aktvendim nuk është i shoqëruar as me shkelje tjera të pretenduara nga pala ankuese nga neni 182, par.2, pika (n), në lidhje me nenin 160, par.4 dhe 5 të LPK-së, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht në rastin konkret.

Gjykata e Apelit, nga ekzaminimi i aktvendimit të goditur me ankesë, gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur ka refuzuar propozimin për caktimin e masës së sigurimit, ngase nga shkresat e lëndës rezulton se propozuesi i masës së sigurimit këtu paditësi me padinë e iniciuar në këtë çështje kontestimore për caktimin e masës së sigurimit për ngastrën lëndore P-71914059-00794-16, me sipërfaqe prej 414 m², e cila tani evidentohet në emër të kundërshtarit të dytë të masës së sigurimit T.T. i cili aktualisht për gjykatën është me vendbanim të panjohur, ndërsa propozuesi siç deklaroi nga sipërfaqja totale e kësaj parcele prej 414 m², e posedon sipërfaqen rreth 200 m², ku jeton dhe ka të ndërtuar shtëpi, dhe posedimin e kësaj sipërfaqeje e ka në bazë të kontratës për shitblerje të paluajtshmërisë (në gjuhën serbe), e pa legalizuar mirëpo vetëm e nënshkruar nga propozuesi dhe kundërshtari i parë i masës së sigurimit Bajram Grisholli nga Prishtina, mirëpo, në përmbajtje të kontratës nuk ceket paluajtshmëria lëndore, mirëpo vetëm çmimi i ngastrës lëndore të shitblerjes prej 29,500 DM, dhe vendi, megjithatë, duke iu referuar provave në shkresat e lëndës, ashtu siç ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, propozuesi me asnjë provë nuk e ka bërë të besueshëm propozimin për caktimin e masës së sigurimit, përkundër faktit se që nga vitit 1998 e tutje është në posedim të sipërfaqes rreth 200 m² të ngastrës lëndore dhe jeton në atë pjesë, ngase kundërshtarët e masës së sigurimit që nga ajo kohë dhe tani me asnjë veprim nuk kanë tentuar që të shesin, ngarkojnë me barrë, tjetërsojnë apo në çfarëdo mënyre t'ia vështirësojnë propozuesit realizimin e të drejtës së tij subjektive në sipërfaqen e poseduar, dhe mbi këtë bazë edhe nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara ligjore për caktimin e masës së sigurimit në rastin konkret në parcelën lëndore P-71914059-00794-16, me sipërfaqe prej 414 m², sipas nenit 297 pika a) të LPK-së ku përcaktohet se vërtetimi i ekzistimit të rrezikut se pa caktimin e masës së sigurimit do të vështirësohet apo pamundësohet realizimi i të drejtës subjektive të propozuesit, këtu nuk është vërtetuar sepse kundërshtari i masës së sigurimit me asnjë provë nuk vërtetohet se ka marrë veprime në drejtim të ndryshimit të gjendjes juridike të ngastrës lëndore objekt i kontestit, dhe nisur nga ky vërtetim i faktit i njëjti edhe nuk e ka ndryshuar gjendjen faktike të ngastrës lëndore, prandaj, në kuptim të nenit 297 pika a) dhe b) në lidhje me nenin 300 par.1 dhe 3 të LPK-së, prandaj, mbi bazën e arsyeve të lartcekura gjykata e shkallës së dytë vlerëson se pretendimet ankimore të propozuesit të masës së sigurimit janë të pa qëndrueshme dhe pa argumentuara në rastin konkret.

Numri i lëndës: 2023:071073
Datë: 24.05.2024
Numri i dokumentit: 05731197

Prandaj, Gjykata e Apelit, mbi bazën e arsyeve të lartcekura, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209, pika (b) të LPK-së, gjeti se duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CA.nr.5245/2024, dt: 23.05.2024

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Besnik Feka